



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
ZYRA E AUDITORIT TË PERGJITHSHEM / KANCELARIJA GENERALNOG
REVIZORA/OFFICE OF THE AUDITOR GENERAL**

Nr. dokumentit:23.13.8-2010-08

**RAPORTI I AUDITIMIT
PËR MENAXHIMIN FINANCIAR, LINJAT E RAPORTIMIT DHE
SISTEMIN E KONTROLLIT NË NDËRMARRJEN TREPÇA NË
ADMINISTRIM TË AKP-së PËR VITIN E PËRFUNDUAR ME 31
DHJETOR 2010**

Prishtinë, Qershor 2011

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
I. Hyrje.....	5
II. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara.....	6
III. Pjesa veriore e Trepçës.....	7
III.1 Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar.....	7
III.2 Pasqyrat financiare.....	9
III.3 Realizimi i Buxhetit.....	9
IV. Pjesa jugore e NSh Trepça	11
IV.1 Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar.....	11
IV.2 Pasqyrat financiare.....	13
IV.3 Realizimi i Buxhetit.....	15
V. Kontrolli Menaxherial	25
V.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm	25
V.2 Auditimi i Brendshëm.....	26
VI. Konkluzion i Përgjithshëm.....	27
Shtojca I. Komentet e NSH Trepça -së dhe përgjigjet e ZAP-së.....	28

Lista e shkurtesave

AB	Auditimi i Brendshëm
AP	Auditori i Përgjithshëm
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
BK	Buxheti i Kosovës
ISA	Institucioni Suprem i Auditimit
LMFPP	Ligji 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë
LPP	Ligji nr.02/L-99 për Prokurimin Publik i ndryshuar dhe plotësuar më 8 shkurt 2007. Përfshirë ligjin e ri, nr. 03/L-241 në fuqi prej 01 dhjetor 2010.
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe e Financave
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm
NSH	Ndërmarrje Shoqërore
OE	Operatori Ekonomik
ONISA	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI)
OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
PVF	Pasqyrat Vjetore Financiare
SNISA	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (ISSAI)
SNKSP	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (IPSAS)
SIMFK	Sistemi Informativ i Menaxhimit Financiar të Kosovës
UA	Udhëzim Administrativ
ZAP	Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

Përmbledhje e përgjithshme

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) ka kryer auditimin e Menaxhimit Financiar, Linjat e Raportimit dhe Sistemit të Kontrollës të Ndërmarrjes Trepça në administrim të AKP-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Auditimi ynë është kryer në pajtim me standardet ndërkombëtare të auditimit, të hartuara nga INTOSAI (SNISA) dhe ka përfshirë testimet dhe procedurat që ne menduam se ishin të nevojshme për të dhënë një konkludim lidhur me Menaxhimin Financiar, Linjat e Raportimit dhe Sistemin e Kontrollit në NSh Trepça.

Konkluzioni ynë i përgjithshëm është se sistemi i brendshëm dhe i jashtëm i raportimit të NSh Trepça nuk funksionon si një tërësi. Ajo është e ndarë në dy pjesë (pjesa jugore dhe pjesa veriore). Të dy pjesët menaxhojnë buxhetin e tyre dhe nuk kanë ndonjë raportim të përbashkët, përpos rrjedhjes së parasë.

NSh Trepça nuk ka status të përcaktuar, andaj i mungon korniza ligjore për disa fusha të caktuara. Kjo është vërejtur sidomos te menaxhimi i të hyrave dhe te menaxhimi i burimeve njerëzore.

Nga pasqyrat financiare vërehet se të dy pjesët kanë rezultat financiar pozitiv dhe ka përmirësim të gjendjes në raport me vitet e mëhershme. Mirëpo ende pjesa me e madhe e të hyrave realizohen nga shitja e koncentrateve të plumbit dhe zinkut.

Te menaxhimi i blerjeve përmes prokurimit nuk kishte kontroll të duhur. Parregullsitë ishin vërejtur nga planifikimi e deri të realizimi i prokurimeve.

Problem serioz është menaxhimi i pasurive. Nuk ka Zyrtar të pasurive dhe nuk janë vlerësuar dhe regjistruar pasuritë.

Andaj me qëllim të përmirësimit të funksionimit të NSh Trepça, ne ju rekomandojmë (Bordin e AKP-së) të siguron:

- Rishikimin e mundësisë për të forcuar bashkëpunimin në mes të dy pjesëve, në mënyrë të integritetit të tyre dhe funksionimit si një tërësi; dhe
- Përcaktimin e statusit të ndërmarrjes.

Për përmirësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrolleve të brendshme, ne ju rekomandojmë (Menaxhmentin e NSh Trepça) të siguron:

- Nxjerrën e të gjitha politikave dhe rregulloreve të brendshme;
- Transparencë gjatë menaxhimit të të hyrave duke siguruar mundësi të barabarta për të gjithë OE;
- Procedura transparente gjatë rekrutimit të stafit;

- Mjedis transparent në menaxhimin e prokurimit; dhe
- Menaxhim të mirë të pasurive, vlerësim dhe regjistrim të tyre.

Menaxhmenti i pjesës jugore të NSh Trepça i ka pranuar të gjeturat dhe konkludimet tona në raportin e auditimit për Sistemin e Kontrollës, Linjat e Raportimit si dhe Menaxhimin Financiar, dhe është zotuar se do të bëjë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

Menaxhmenti i pjesës veriore të NSh Trepça ka bërë komente lidhur me këtë raport, të cilat i kemi paraqitur në shtojcën 1.

I. Hyrje

Ky auditim ka të bëjë me Menaxhimin Financiar, Linjat e Raportimit dhe Sistemin e Kontrollit në Ndërmarrjen Trepça në administrim të AKP-së për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Është përgjegjësi e Menaxhmentit të NSh Trepça të ndërtohet një sistem (procedura, ambient) për menaxhimin e të gjitha aktiviteteve (të brendshme dhe të jashtme) në kompani. Po ashtu Ndërmarrja Trepça duhet të përgatisë pasqyrat dhe raportet financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimin financiar në bazë të parimit akrual të kontabilitetit.

Auditimi Menaxherial është definuar si verifikim i kontrolleve, vlerësim i menaxhimit financiar dhe raportimin e brendshëm dhe të jashtëm.

Në këtë auditim ne kemi analizuar:

- Nëse është vendosur udhëheqje në menaxhimin financiar për të siguruar menaxhim të duhur;
- Nëse raportet e brendshme dhe të jashtme lidhur me aktivitetet dhe shpenzimet janë të besueshme;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin për kontrollet dhe menaxhimin financiar në përgjithësi.

Fillimisht ne kemi kryer një auditim të përkohshëm, dhe kemi dhënë këshilla për përmirësimin e menaxhimit financiar gjatë vitit aktual. Këshillat tona lidhen me çështjet në

Sistemin e kontrollës, Linjat e Raportimit si dhe Menaxhimin Financiar, përmes memorandumit të auditimit të dorëzuar në Dhjetor 2010.

Në këtë auditim ne kemi ndërmarrë aktivitetet si në vijim:

- Kemi rishikuar raportet e NSh Trepça, në raport me buxhetin e miratuar për vitin 2010;
- Kemi rishikuar sistemin e kontrollit të brendshëm, rregulloret, politikat dhe vendimet e nxjerra nga NSh Trepça, si dhe aplikimi i tyre gjatë menaxhimit të organizatës;
- Kemi përcaktuar nivelet e materialitetit të të hyrave dhe shpenzimeve, si prag për lehtësimin e përcaktimit të konkludimit tonë mbi raportet financiare;
- Kemi zbatuar një kombinim të mostrimit sipas gjykimit dhe sipas rastit, në përzgjedhjen e transaksioneve për testim;
- Kemi kryer teste të kontrolleve si dhe testime substanciale gjithëpërfshirëse mbi transaksionet financiare;
- Jemi mbështetur në një lloj kombinimi të intervistave, rishikimeve analitike, rishikimin e dokumenteve dhe verifikimin fizik për të vlerësuar vlefshmërinë dhe rregullsinë e transaksioneve financiare; dhe
- Kemi vlerësuar cilësinë e punës së Njësisë së Auditimit të Brendshëm të NSh Trepça.

Në këtë raport ne përmbledhim auditimin e këtij viti lidhur me menaxhimin financiar, raportimin dhe kontrollet, dhe japim një konkludim mbi cilësinë dhe funksionimin e tyre.

II. Gjendja e rekomandimeve të viteve të kaluara

Vitin e kaluar, N.Sh. Trepça nuk kishte bërë auditimin e pasqyrave financiare të vitit 2009. Mirëpo ne gjatë auditimit të pasqyrave të AKP-së për vitin 2009, kemi mbuluar pjesën e subvencioneve dhe projekteve kapitale të cilat kjo agjenci i kishte dhënë NSh Trepçës nga Buxheti i Kosovës. Nga ky auditim ne kemi dhënë rekomandime për të forcuar procesin e menaxhimit të subvencioneve dhe projekteve kapitale.

Menaxhmenti i NSh Trepça pjesa jugore ka përgatitur një plan të adresimit të rekomandimeve tona, mirëpo plani ende nuk është realizuar.

Rekomandimet të cilat janë në proces të adresimit lidhen me kontrollin në menaxhimin e procesit të prokurimit dhe me forcimin dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi 1

Rekomandojmë Bordin e AKP të siguroj që Menaxhmenti i NSh Trepça siguron që:

- Rekomandimet janë të adresuara në vazhdimësi duke deleguar detyra dhe veprime konkrete tek personat përgjegjës, përfshirë afatet kohore për kryerjen e tyre.

III. Pjesa veriore e Trepçës

III.1 Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Tabela Nr.1 Pasqyra e të ardhurave

Të ardhurat nga shitjet e prodhimeve	12,963,410
Çmimi i shitjes së produkteve – shpenzimet e drejtpërdrejta të prodhimit	
Kostot e lëndëve të para	3,338,811
Pagat e punëtorëve	3,838,770
Shpenzimet e tjera të drejtpërdrejta	2,105,156
Kostoja totale e prodhimit	9,282,737
Totali i fitimit bruto nga shitja e produktit	3,680,673
Të hyrat nga shërbimet e tjera	57,803
Të ardhurat nga qiraja	64,211
Të hyrat tjera	9,415
Totali i të ardhurave nga veprimtari të tjera	131,429
Shpenzimet Operative dhe të përgjithshme	
Shpenzimet e pagave të kontraktuara - kontrata mbi vepër	3,539
Bursat për punëtorë	708,698
Shpenzimet për ndihmë të njehershme	131,650
Shpenzimet e postës, shërbimet bankare	31,007
Shpenzimet për publikime	5,075
Shpenzimet e mirëmbajtjes	478,143
Shpenzimet për shkollimin profesional të punëtorëve	2,559
Shpenzimet e transportit, shërbimeve dhe ngarkimit	25,309
Shpenzimet e zyrës, mirëmbajtjes dhe prokurimit	21,968
Shpenzimet e vlerësimit të rrezikut në ambientin e punës	9,836
Shpenzimet e shërbimeve mjekësore	1,908
Shpenzimet e sigurimit të punëtorëve	15,108
Shpenzimet e rrymës elektrike	2,107,327
Shpenzimet e ujit	27,000
Shpenzimet e telefonit dhe internetit	31,380
Shpenzimet tjera të përgjithshme	8,320
Shpenzimet e shërbimeve komunale	8,943

Shpenzimet e shërbimeve të transportit të punëtorëve	15,848
Shpenzimet e udhëtimeve zyrtare dhe reprezentacionit	15,685
Shpenzimet HTZ	56,484
Shpenzimet e ushqimit të punëtorëve	142,958
Donacionet e dhëna dhe sponsorimet	11,925
Shpenzimet e regjistrimit të automjeteve	10,013
Shpenzimet e anëtarësisë	8,516
Shpenzimet tjera	15,346
Gjithsejtë shpenzimet tjera dhe operacionale	3,894,546
Subvencionet për paga dhe bursa nga BK	737,495
Subvencionet për investime kapitale	325,863
Gjithsejtë subvencionet	1,063,358
Fitimi/humbja e vitit para tatimit	980,913

Tabela Nr.2. Bilanci i Gjendjes

AKTIVA	
Mjete qarkullues	
Para të gatshme	1,469,441
Llogari të arkëtueshme	429,341
Të arkëtueshme tjera	4,197,944
Gjithsej mjete qarkulluese	6,096,726
Mjete themelore	
Gjithesejt mjete themelore	0
Gjithesejt mjete	6,096,726
PASIVA	
Obligime afatshkurta	
Detyrimet nga veprimtaria	4,098,808
Detyrimet për pagat e punëtorëve	462,122
Detyrimet tjera afatshkurtra financiare	2,052,771
Gjithsej obligime afatshkurta	6,613,701
Kapitali	
Humbja/fitimi i viteve të kaluara	-1,497,888
Humbja/fitimi i vitit vijues	980,913
Gjithsej kapitali	-516,975
Gjithsej ekuiteti	6,096,726

Ne kishim kufizim të fushëveprimit për përfundimin e auditimit në pjesën veriore të NSh Trepça. Sipas menaxhmentit të asaj pjese arsye ishin problemet politike.

Kjo pjesë e ka caktuar një person kontaktues (Zyrtaren e Financave) e cila ka kontaktuar disa herë me ne dhe na ka sjellë disa dokumente, përfshirë edhe pasqyrat financiare. Po ashtu një takim e kishim edhe me Zëvendës drejtorin Menaxhues, mirëpo të gjitha këto janë organizuar vetëm në pjesën jugore të NSh Trepça.

Mirëpo kjo nuk kishte mjaftuar për të përfunduar auditimin tonë. Ne nuk kemi arritur të testojmë:

- Dizajnimin dhe funksionimin e kontrolleve në atë pjesë;
- Të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet sa janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi; dhe
- Për çështjet tjera që dalin lidhur me auditimin.

III.2 Pasqyrat financiare

Pjesa veriore e NSh Trepça duhet të administrohet, monitorohet dhe kontrollohet nga AKP. Kjo ndërmarrje duhet ti raportoj AKP-së për aktivitetet operative dhe financiare të saj.

Përpos kësaj AKP kishte transferuar fonde për subvencione dhe projekte kapitale. Këto ishin të rregulluara në bazë të Marrëveshjes për Kontroll dhe Monitorim (MMK).

Pjesa veriore e NSh Trepça nuk kishte dorëzuar raporte në AKP për aktivitetet operative të saj. Ajo kishte dorëzuar vetëm pasqyrën e rrjedhjes së parasë dhe atë e kishte dorëzuar me qëllim të përfitimit të subvencioneve.

III.3 Realizimi i Buxhetit

3.1 Të hyrat

Pjesa veriore e NSh. Trepça nuk na ka siguruar informata të mjaftueshme rreth të hyrave të grumbulluara. Sipas pasqyrës së të ardhurave vërejmë se për vitin 2010 kjo pjesë ka grumbulluar të hyra në vlerë prej 13,094,838€ Për grumbullimin e këtyre të hyrave nuk kemi burime të informatave (të dhëna burimore). Në bazë të intervistave që kemi zhvilluar me personelin e pjesës veriore vlerësojmë se këto të hyra janë kryesisht nga nxjerrja e koncentrateve nga dy miniera, ndërsa shkriticorja është plotësisht jo funksionale.

3.2 Shpenzimet

Ne nuk kishim një pasqyrë të qartë për realizimin e shpenzimeve për Pjesën Veriore të NSh Trepça. Për shkak të kufizimit të fushëveprimit të auditimit ne kemi arritur të ekzaminojmë vetëm dy mostra në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve të cilat kapin vlerën prej 339,000€

Nga këto dy mostra ne kemi vërejtur se kontrollet janë të dobëta në menaxhimin e mallrave dhe shërbimeve.

Kontroll i dobët në menaxhimin e mallrave dhe shërbimeve në NSh Trepça

Tejkalimi i shërbimeve të kontraktuara. Vlera e kontratës ishte 9,000€ ndërsa faturimi ishte në vlerë prej 17,621€ Si pasojë e tejkalimeve të kontratave NSh Trepça mund të vijë deri të mos arritja e përmbushjes së obligimeve.

Konkluzioni

AKP nuk ka arritur të administroj dhe monitoroj pjesën veriore të NSh Trepça. Po ashtu ne nuk kemi arritur ta realizojmë auditimin tonë në këtë pjesë, pasi nuk kanë pranuar Menaxhmenti i saj. Arsye sipas tyre ishin problemet politike.

Rekomandimi 2

Rekomandojmë Bordin e AKP-së të siguroj:

- Rishikimin e mundësisë për të forcuar bashkëpunimin në mes të dy pjesëve, në mënyrë të integritit të tyre dhe funksionimit si një tërësi.

IV. Pjesa jugore e NSh Trepça

IV.1 Rezultati financiar në krahasim me Buxhetin e Aprovuar

Analiza e Rezultatit në Pasqyrat Financiare kundrejt Buxhetit të Aprovuar tregon:

Tabela 3: Pasqyra e të ardhurave

	Planifikimi 2010	Realizimi 2010	Realizimi 2009
Të hyrat nga shitja	9,808,631	10,338,682	6,232,048
Të hyrat nga Terminali Doganor	720,200	1,034,138	768,300
Të hyrat nga qiraja	130,800	177,573	157,431
Të hyrat tjera	0	894,820	448,440
Gjithsej të hyrat	10,659,631	12,445,213	7,606,219
Pagat	6,862,562	7,091,943	6,363,582
Pensionet e parakohshme	480,300	447,960	490,080
Stipendionet	144,000	126,323	141,284
Furnizimet me të mira dhe shërbime	1,796,216	2,287,385	2,752,081
Energjia elektrike	1,621,773	1,647,068	941,084
Riparime dhe pjesë ndërrimi	374,400	221,042	203,272
Gjithsej shpenzimet	11,279,251	11,821,722	10,891,383
Fitimi/humbja para shp. të amortizimit	(619,620)	623,491	(3,285,163)
Shpenzimet e amortizimit	516,492	616,329	516,489
Fitimi/humbja para tatimit në fitim	(103,128)	7,162	(3,801,652)
Tatimi në fitim të korporatave (10%)	0	716	0
Rezultati financiar pas tatimit në fitim	(103,128)	6,446	(3,801,652)
Subvencione nga BK	1,911,380	1,911,380	3,594,737

Nga tabela vërehet se gjatë vitit 2010 NSh Trepça pjesa jugore kishte rritje të madhe të të hyrave në raport me vitin 2009. Rritja ishte për 4,838,994 ose 63%, që ishte rezultat i të hyrave nga shitja e EIMCO fundërrinës si dhe nga rritja e të hyrave tjera. Kjo ka ndikuar në përmirësimin e rezultatit financiar të ndërmarrjes në raport me vitin 2009.

Te shpenzimet në vitin 2010 ka pasur rritje krahasuar me vitin 2009. Rritjet ishin në pozicionin e pagave, energjisë elektrike dhe të shpenzimet të amortizimit.

Konkluzioni

Pjesa jugore e NSh Trepça kishte një realizim të mirë të buxhetit nëse e shohim si tërësi. Realizimi i mirë vërehet në të hyrat.

Tabela 2. Bilanci i gjendjes

Përshkrimi	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Mjete qarkullues		
Para të gatshme	6,363,321	3,819,601
Stoqet (e produkteve të gatshme, gjysmeprodukteve)	2,694,766	2,249,661
Llogari të arkëtueshme	2,286,597	940,742
Kërkesa për parapagime	25,220	10,124
Kërkesat për tatimet e paguare me tepër	441,900	435,269
Gjithsej mjete qarkulluese	11,811,804	7,455,397
Mjete themelore		
Koncesione, të drejtat industriale dhe të drejtat e ngjashme dhe asetet si dhe licencat në këto asete dhe të drejta	7,595	0
Ngastra, prona dhe ndërtesa	535,260	493,654
Pajisje dhe makineri	6,022,560	6,243,425
Pajisje tjera, orendi dhe pajisje të zyrës	134,386	20,511
Gjithsej mjete themelore	6,699,803	6,757,590
Gjithsej Pasuritë	18,511,607	14,212,988
Detyrimet		
Obligime afatshkurta		
Llogari të pagueshme	4,668,201	4,677,936
Paga të pagueshme	582,379	577,772
Obligimi për TVSH të papaguar	0	29,889
Obligimet për të hyrat e paguara	1,260,524	522,525
Obligimet tjera afatshkurta	50,000	50,000
Gjithsej obligime afatshkurta	6,561,105	5,858,122
Ekuiteti		
Kapitali i ndërmarrjes	16,799,410	13,208,530
Humbja/fitimi i viteve të kaluara	-4,855,354	-4,645,454
Humbja/fitimi i vitit vijues	6,446	-208,210
Gjithsej Ekuiteti	11,950,502	8,354,866
Gjithsej Detyrimet dhe Ekuiteti	18,511,607	14,212,988

Pjesa jugore e NSh Trepça ka arritur të operoj në vitin e fundit me bilanc pozitiv duke arritur fitim në vlerë prej 6,446€

Te llogaritë e arkëtueshme vërehet një rritje e madhe gjatë vitit 2010. Nga 940,741€ në vitin 2009 ato janë rritur në 2,286,597€ Rritja e të arkëtueshmeve në nivel dukshëm më të lartë se vitin paraprak e rritë rrezikun për krijimin e borxheve të këqija dhe të dyshimta.

Në vitin 2010 Kapitali është rritur për 3,590,879€ Kjo rritje e kapitalit ka ndodhur si rezultat i prezantimit jo të drejtë të subvencionit dhe projekteve kapitale të përfituara nga BK. Këto mjete janë paraqitur si rritje e kapitalit në bilancin e gjendjes.

IV.2 Pasqyrat financiare

2.1 Pajtueshmëria në lidhje me raportimin e jashtëm

NSh Trepça administrohet, monitorohet dhe kontrollohet nga AKP. Kjo ndërmarrje i raporton AKP-së për aktivitetet operative dhe financiare të saj. Nuk ekziston një formë e qartë e shkruar e cila do të rregullonte procesin e raportimit. Mirëpo bazuar në intervista të zhvilluara me zyrtarë të NSh Trepça dhe AKP-së forma e raportimit zhvillohet si vijon:

Menaxhmenti i NSh Trepça dërgon raporte mujore, tre mujore, gjashtë mujore si dhe raporte vjetore në AKP. Pastaj AKP përmes Bordit të Drejtorëve i raporton Kuvendit të Kosovës përmes raporteve tremujore në të cilat i pasqyrojnë rezultatet financiare dhe operative.

AKP çdo vit transferon fonde për projekte Kapitale si dhe subvencione në NSh Trepça. Këto transfere janë të rregulluara në bazë të Marrëveshjes për Kontroll dhe Monitorim (MMK).

Sipas kësaj marrëveshje NSh Trepça duhet të dorëzojë raporte me shkrim në AKP lidhur me aktivitetet e saj financiare. Raportet dorëzohen në Departamentin e Buxhetit dhe Financave dhe në Njësinë e Prokurimit.

Raportet e dorëzuara në departamentin e buxhetit dhe financave:

- Raporte mujore financiare;
- Raporte tremujore për përdorimin e subvencioneve;
- Pasqyrë të konsoliduar të rrjedhjes së parasë së gatshme; dhe
- Pasqyrën origjinale bankare të vulosur nga banka.

Ndërsa në Njësinë e Prokurimit dorëzohen këto raporte:

- Kopjet e kontratave të prokurimit të financuara nga BK; dhe
- Planin dhe regjistrin e prokurimit.

Pjesa Jugore e NSh Trepça i kishte dorëzuar këto raporte gjatë vitit 2010.

2.2 Cilësia e informatave

Ne analizuam cilësinë e këtyre informatave të pasqyrat financiare të NSh Trepça pjesa jugore dhe kemi shpalosur parregullsitë në vijim:

Regjistrat e kontabilitetit; gjegjësisht kartela e të hyrave nga shitja e EIMCO fundërrinës përmbante edhe të hyra tjera (të hyra nga shitja e fërgesës) në vlerë prej 41,254€ si dhe të hyrat nga shitja e acidit sulfurik në vlerë prej 300€

NSh Trepça përfiton subvencion nga BK çdo vit. Në vitin 2010 pjesa jugore e saj kishte përfituar nga BK subvencione në vlerë prej 1,911,380€ Këto mjete janë përdorur për paga dhe stipendione. Prezantimi i këtij subvencioni në pasqyrën e të ardhurave nuk është bërë në formën e duhur, ngase nuk është prezantuar si e hyrë (Subvencion nga BK) dhe si shpenzim për pagat dhe stipendionet e paguara nga ky subvencion.

Konkluzioni

Pjesa jugore e NSh Trepça nuk ka prezantuar subvencionet në pajtim me SNK-të. Më përjashtim të kësaj dhe disa gabimeve të cilat nuk kanë ndikim material, të dhënat financiare dhe raportet e saj japin informata të sakta në pajtim me raportimin financiar në bazë të kontabilitetit sipas parimit akrual.

Rekomandimi 3

Rekomandojmë menaxhmentin e NSh Trepça të siguroj:

- Të gjitha të hyrat të regjistrohen sipas kodeve adekuate në mënyrë që të dhënat dhe raportet e tyre të japin informata të sakta; dhe
- Prezantimin e drejtë të subvencioneve dhe transfereve për projekte kapitale, në pajtim me SNK sipas parimit akrual të kontabilitetit.

IV.3 Realizimi i Buxhetit

3.1 Të hyrat

Plani i të hyrave të pjesës jugore NSh Trepça për vitin 2010 ishte 10,659,631€ Gjatë kësaj periudhe kishte grumbulluar të hyra në vlerë 12,416,779€ ose kishte tejkaluar planin për 16%.

Nr.	Përshkrimi	Vlera ne Euro
1	Të hyrat nga shitja e koncentratit të plumbit	6,052,213
2	Të hyrat nga shitja e koncentratit të zinkut	2,063,764
3	Të hyrat shitja e mbeturinave	1,980,787
4	Të hyrat nga shërbimet e Terminalit doganore	1,034,138
5	Diferenca pozitive e kursit të këmbimit të valutave	371,212
6	Të hyrat tjera	399,750
7	Të hyrat nga shitja e aluminiut sulfatit	241,918
8	Të hyrat nga qiraja nga ndërtesat	177,573
9	Të hyrat nga kamatat	95,424
	Totali i të hyrave për këtë periudhë	12,416,779

Nga këto ne ekzaminuam të hyrat nga: shitja e koncentratit të plumbit, koncentratit të zinkut, shitja e mbeturinave (EIMCO Fundërrina), shërbimet e terminalit doganore, shitja e aluminiut sulfatit si dhe qiraja nga ndërtesat.

Të hyrat nga Shitja e koncentratit të Plumbit, Zinkut dhe aluminiut sulfatit

NSh Trepça gjatë vitit 2010 ka grumbulluar të hyra nga shitja e Koncentratit të Plumbit, Zinkut dhe Alumin Sulfatit. Në vijim paraqesim planifikimin dhe grumbullimin:

Shitja e Koncentratit të Plumbit: Të hyrat e planifikuara për shitjen e koncentratit të Plumbit për vitin 2010 ishin në vlerë 7,371,079€ Realizimi ishte 6,052,213€ ose 82%.

Shitja e Koncentratit të Zinkut: Të hyrat e planifikuara për shitjen e koncentratit të Zinkut për vitin 2010 ishin në vlerë 2,257,553€ Realizimi ishte 2,063,764€ ose rreth 91%.

Shitja e Aluminiut Sulfatit: Të hyrat e planifikuara për shitjen e koncentratit të Aluminiut Sulfatit për vitin 2010 ishin 138,000€ ndërsa janë realizuar 241,918€ Krahasuar me vitin e kaluar e rritur për 75%.

Nga secila kategori e këtyre të hyrave ne testuam nga një kontratë dhe kemi vërejtur se nuk ka kontroll të mjaftueshëm në menaxhimin e tyre.

Nuk ka politika të qarta të cilat e rregullojnë procesin e shitjes së koncentratit të plumbit dhe zinkut

Pjesa jugore e NSh Trepça nuk kishte politika të qarta për rregullimin e procedurave të shitjes së koncentratit të zinkut dhe të plumbit. Në mungesë të tyre ka aplikuar disa pika të Ligjit të prokurimit Publik. Kjo ka sjellë paqartësi gjatë menaxhimit të të hyrave.

Megjithatë në muajin nëntor të vitit 2010 është hartuar rregullorja për menaxhimin e të hyrave, e cila ende nuk është aprovuar nga AKP.

Nuk shpërblehet me kontratë ofertuesi me çmim më të lartë

Nuk i është dhënë tenderi ofertuesit me çmimin më të lartë. Pas përfundimit të procedurave të tenderit, disa ofertues janë ftuar për bisedime në mënyrë që të negociohet çmimi. Kjo procedurë dëmton konkurrencën e tregut, duke favorizuar Operatorin Ekonomik (OE) të caktuar.

Shpërblehet me kontratë ofertuesi i pa përgjegjshëm ekonomikisht si dhe nuk kishte shpallje të rezultateve publike

OE fitues sipas kriterëve të përcaktuara ishte i pa përgjegjshëm pasi që nuk ka dorëzuar dokumentet kryesore të kërkuara me tender, si dhe nuk ka paguar depozitën e kërkuar për sigurim të tenderit në vlerë prej 50,000\$. Sipas Zyrtareve të NSh Trepça ky OE i kishte të gjitha dokumentet në dosjet e tyre pasi që me të njëjtin OE kishin kontratë edhe me herët. Kjo procedure na shpjegon në mendimin se NSh Trepça ka favorizuar OE fitues të tenderit.

Shpallja e fituesit nuk ishte bërë përmes gazetës. Zhvillimi i këtij procesi deri të shpallja e fituesit tregon mungesë të plotë të transparencës.

Parregullsi gjatë shitjes së aluminium sulfatit

Pjesa jugore e NSh Trepça ka nënshkruar një kontratë standarde për furnizimin e ujësjellësve të Kosovës me aluminium sulfat. Në këtë kontratë nuk specifikohet:

- Sasia maksimale për të cilën Trepça është futur në obligim ndaj kontraktuesit; dhe
- Forma e pagesës që kontraktuesi i detyrohet Trepçës.

Konkluzioni

Pjesa jugore e NSh Trepça nuk ka arritur të krijojë Politika ose rregullore të brendshme të cilat do të rregullonin procedurat e shitjes prej inicimit të procedurave, kontraktimit, realizimit e deri të raportimi. Kjo përbën rrezik në vete për zvogëlimin e konkurrencës për shitjen e produkteve të saj, e cila në mënyrë indirekte kanë ndikim në rezultatin financiar të ndërmarrjes.

Rekomandimi 4

Rekomandojmë Menaxhmentin e NSh Trepça të siguroj:

- Sistem funksional të kontrollit duke hartuar politika (rregulla) të qarta të cilat i rregullojnë procedurat e shitjes;
- Mjedis sa me konkurrues dhe transparent gjatë tërë procesit të shitjes, në mënyrë që të sigurojë sa me shumë ofertues. Kjo në mënyrë indirekte mund të ndikoj edhe në rezultatin financiar të saj; dhe
- Vlerësim të drejtë të ofertave duke ju përmbajtur të gjitha kriterëve të përcaktuara në mënyrë që të zgjidhet OE më i përshtatshëm.

Shitja e mbeturinave Industriale

EIMCO-fundërrina është një mbetje metalurgjike (mbetje e procesit teknologjik, në elektrolizën e Zinkut), që është e deponuar pranë Metalurgjisë së Zinkut në Parkun Industrial. Është deponuar përgjatë dhjetëvjeçarit të punës së Metalurgjisë së Zinkut.

Kjo mbeturinë është shumë ndotëse për ambientin, gjë që është konstatuar edhe nga studimet që ka bërë kompania çeke Dekonta (e specializuar në fushën e mjedisit).

Komisioni i pjesës jugore të NSh Trepça ka raportuar se kompania fituese është e obliguar me kontratë që pasi ta heq gjithë materien duhet ta rehabilitoj këtë sipërfaqe, duke e shndërruar në hapësirë të gjelbër.

Procedurat rreth përzgjedhjes se OE janë zhvilluar në vitin 2009 dhe ishte bërë përmes procedurave të hapura.

Gjatë vitit 2010 EIMCO Fundërrinë janë liferuar gjithsej 176,747.20 ton. Çmimi për një ton ishte 13€ Të hyrat nga shitja e EIMCO Fundërrinës për vitin 2010 kanë qenë 1,980,787€pa TVSh.

Të Hyrat nga Qiraja

Pjesa jugore e NSh Trepça krijon të hyra nga qiraja (dhënia e objekteve dhe pajisjeve në shfrytëzim). Të hyrat nga qiraja dhe ndërtesat për periudhën 2010 kapin vlerën prej 177,573€ Ne kemi ekzaminuar disa objekte dhe pajisje të dhëna në shfrytëzim nga ana e Trepçës. Si rezultat i testeve tona të gjeturat përfshijnë:

Mungojnë politikat (rregullat) përmes të cilave rregullohet qiradhënia

Mungonin politikat për caktimin e tarifave për qiradhënie të objekteve dhe pajisjeve të cilat i jep në shfrytëzim me qira. Megjithatë rregullorja e cila është në proces të aprovimit nga AKP e rregullon edhe menaxhimin e këtyre të hyrave.

Te objekti i dhënë me qira për KEK-un kontrata nuk përcaktonte saktë se sa është sipërfaqja e objektit si dhe një listën e pajisjeve që është e dhënë në shfrytëzim.

Kontrata e qirasë e ripërsëritur disa vite me radhë duke mos u bërë publike

Kontrata për Agjentin Doganor Mega Plast është ripërsëritur disa vite me radhë duke mos bërë shpallje publike. Në këtë mënyrë pjesa jugore e NSh Trepça i ka ikur transparencës dhe nuk ka siguruar çmim konkurrues (çmim të tregut).

Konkluzioni

Mungesa e rregulloreve përmes të cilave rregullohet çështja e dhënies objekteve dhe pajisjeve me qira orientojnë në nivel të ulët të kontrollit.

Rekomandimi 5

Rekomandojmë Menaxhmentin e NSh Trepça të siguroj:

- Hartimin e politikave të qarta të cilat i rregullojnë procedurat e dhënies me qira të objekteve dhe pajisjeve dhe të nënshkruaj kontrata për dhënien e tyre; dhe
- Mjedis konkurrues dhe transparent gjatë tërë procesit të dhënies me qira të objekteve.

Të hyrat nga Terminali Doganor

NSh Trepça realizon të hyra në bazë të kontratës mbi koncesionimin e terminalit doganor, duke ofruar shërbime përmes infrastrukturës së “Terminalit Doganor – Trepça” ndaj Degës Doganore të Mitrovicës. Inkasimi i të hyrave dhe aktivitetet tjera përkatëse realizohen në bazë të “Rregullores së Punës të Terminalit Doganor Trepça të nënshkruar në vitin 2009”.

Të hyrat e raportuara në Pasqyrat Financiare për vitin 2010 janë 1,034,138€ Ne kemi testuar të hyrat në vlerë prej 18,914€ Procesi është testuar në përgjithësi nga pranim / dorëzimi i biletave (kuponëve) deri tek inkasimi i mjeteve. Po ashtu kemi testuar në detaje 17 pagesa, duke filluar nga shpërndarja e biletave deri te inkasimi i mjeteve dhe regjistrimi në kontabilitet.

Sipas testeve të bëra, të hyrat janë realizuar në përputhje me kontratën dhe rregulloren e punës në fuqi.

3.2 Shpenzimet

Blerjet përmes prokurimit

Për vitin 2010 pjesa jugore e NSh Trepça kishte realizuar shpenzime përmes prokurimit në vlerë prej 5,648,555€ Prej tyre 3,989,220€ për mallra dhe shërbime (të financuara nga të hyrat vetanake), ndërsa 1,659,335€ për projekte kapitale (1,609,349€ të financuara nga BK, ndërsa 49,985 të financuara nga të hyrat vetanake).

Në kuadër të këtyre shpenzimeve ne kemi testuar gjithsej 16 mostra të cilat arrijnë vlerën 1,010,385€ përkatësisht 17% e popullacionit (një mostër nga kategoria e investimeve kapitale ndërsa 15 nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve).

Gjatë procesit të testimit të këtyre shpenzimeve kemi vërejtur se nuk ka kontroll të mjaftueshëm në menaxhim.

Nënshkrimi i kontratës në mungesë të tre OE

Në kontratën furnizim me pjesë ndërrimi për kamionë, kontrata është shpërblyer në mungesë të tre OE të përgjegjshëm. Njeri nga OE nuk e kishte sjellë listën e furnizimeve kryesore për tri vitet e fundit. Dhënia e kontratës në mungesë të tri ofertave të përgjegjshme dëmton konkurrencën e tregut duke bërë favorizime ndaj OE të caktuar.

Pjesa jugore e NSh Trepça nuk kishte arritur që të hartoj një plan të shpenzimeve mbi nevojat reale për vitin 2010

Për furnizime me derivate të naftës janë planifikuar 128,500€ përderisa kontratat e nënshkruara për furnizim me naftë për vitin 2010 kapin vlerën prej 461,296€

Shpërblehet disa herë me kontratë për kuotim të çmimeve i njëjti OE

Gjatë vitit 2010 janë realizuar disa prokurime përmes kuotimit të çmimeve për shpenzimet e derivateve të naftës me të njëjtin OE. Te këto kontrata nuk ishte respektuar neni 35.2 i LPP-së (sipas këtij neni kuotimi duhet të përdoret për raste urgjente për shuma të vogla). Vlera e përgjithshme e këtyre kontratave përfshin shumën prej 82,448€

Pjesa jugore e NSh Trepça përmes kësaj forme i ka ikur procedurave transparente duke favorizuar OE fitues.

Këto procedura ishin përdorë pasi OE që kishin kontratë për furnizim nuk kishte arritur ti furnizoj me karburante. Andaj edhe kanë shkëputë kontratën me këtë OE.

Parregullsi gjatë furnizimit me derivate të naftës

Në kontratën për furnizim me derivate të naftës të nënshkruar me OE “Bajraktari” në vlerë prej 124,088€ kemi vërejtur një varg parregullsish:

- Mos respektimi i afateve kohore të parapara me LPP. Sipas LPP njoftimi publikë duhet të bëhet për 25 ditë kalendarike, derisa pjesa jugore e NSh Trepça ka shkurtuar vetëm në 14 ditë. Shkurtime të afateve kohore nuk ofrojnë mjedis konkurrues transparent për të gjithë konkurruesit;
- Pjesa jugore e NSh Trepça e ka nënshkruar kontratën për furnizim me derivate edhe pse OE kishte dështuar të ofroj të gjitha dokumentet e kërkuara në dosje të tenderit (nuk kishte ofruar dëshmitë për ujë dhe ngrohje); dhe
- Mjetet e dedikuara nga BK për investime kapitale kontraktohen në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve. Nënshkrimi i kontratës dhe zotimi i mjeteve është bërë nga këto mjete duke mos respektuar marrëveshjen për Monitorim dhe Kontroll. Edhe pse pagesa nuk është bërë me mjete të BK për shkak të shpërbërjes së kontratës me OE mund të vijmë në përfundim se nuk kishte kontroll në këtë proces.

Ndërprerja e kontratës me OE “Bajraktari” është bërë për shkak se nuk ka arritur t’i furnizoj me derivate. Bazuar në këtë ka shpallë tender të ri për furnizim me karburante. Në këtë tender ka fituar OE “HIB Petrol” në vlerë prej 254,760€. Në menaxhimin e kësaj kontrate po ashtu kemi vërejtur parregullsi:

- Raporti i vlerësimit është bërë nga anëtarët të cilët nuk janë caktuar (emëruar) si anëtar të komisionit. Ndryshimi i njërit nga anëtarët e komisionit për vlerësim orienton në një kontroll të dobët dhe menaxhim jo cilësor gjatë përzgjedhjes së ofertuesve fitues; dhe
- Pjesa jugore e NSh Trepça ka nënshkruar kontratën për furnizim me derivate me OE Fitues pa e nënshkruar deklaratën e nevojave dhe disponueshmërisë së mjeteve. Mungesa e disponueshmërisë së mjeteve mund ta shtyjë NSh Trepça drejt obligimeve ndaj furnitorëve.

Mungesë e kontrollit për shpenzimet e ndodhura dhe përcjelljes së stokeve

Menaxhimi dhe raportimi për shpenzimet e ndodhura të derivateve të naftës nuk funksionon si duhet.

Pjesa jugore e NSh Trepça ka rezervarë të naftës në të cilët mbahen rezervat. Për gjendjen e rezervave Njësia e kërkesës nuk raporton të Departamenti i Financave. Andaj regjistrimet në kontabilitet për derivatet e naftës bëhen në bazë të faturave të pranuar dhe jo në bazë të shpenzimeve të ndodhura.

Parregullsi në realizimin e kontratës për furnizim me eksploziv dhe mjete ndezëse

Në kuadër të shpenzimeve për investime kapitale ne kemi testuar kontratën “Furnizim me eksploziv dhe mjete ndezëse” në vlerë prej 301,159€ Këto shpenzime janë financuar nga BK.

Kontrata është shpërblyer në mungesë të tre OE të përgjegjshëm. Nga katër OE vetëm fituesi i kontratës ishte i përgjegjshëm. Për dhënien e kontratës kishin marrë aprovimin nga APP.

Konkluzioni

NSh Trepça ende nuk ka arritur të krijojë një mjedis konkurrues dhe transparent gjatë menaxhimit të shpenzimeve të saj. Kjo vërehet nga mungesa e numrit të mjaftueshëm të ofertuesve të përgjegjshëm.

Menaxhimi i shpenzimeve për investime kapitale nuk ishte bërë në përputhje të plotë me kornizën e aplikueshme ligjore. Mungonte numri i mjaftueshëm i ofertuesve të përgjegjshëm. Kjo e dëmton edhe me tej konkurrencën në mes ofertuesve, gjë që mund të ketë ndikim edhe menaxhimin e buxhetit në tërësi.

Rekomandimi 6

Rekomandojmë Menaxhmentin e NSh Trepça të siguroj që:

- Gjatë hartimit të planit të prokurimit të parashihen të gjitha prokurimet që mund të zhvillohen me procedura të hapura. Procedurat e kuotimit të çmimeve të përdorën në pajtim me LPP-në vetëm për furnizime apo shërbime me vlera minimale ose të vogla;
- Të respektohen afatet kohore për shpallje publike dhe kontratat të nënshkruhen në përputhje me kriteret të cilat janë në dosje të tenderit;
- Gjatë vlerësimit të tenderëve komisioni i vlerësimit duhet ti përmbahet kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit. Në bazë të vlerësimit të kontraktohen OE me të përgjegjshëm dhe që ofrojnë çmime më të volitshme;
- Në rastet kur ka më pak se tri oferta të përgjegjshme për kontratë procesi i prokurimit duhet të anulohet dhe të aplikohet ritenderimi; dhe
- Të vendosin një sistem të mirëfilltë të kontrollit rreth menaxhimit të derivateve të naftës dhe të regjistrohen sipas parimit aktual.

Blerjet tjera

Te blerjet tjera janë të gjitha blerjet për mallra dhe shërbime të cilat nuk kanë kaluar përmes procedurave të prokurimit. Në këtë kategori ne kemi testuar shpenzimet e energjisë elektrike.

Shpenzimet e energjisë elektrike për vitin 2010 ishin 1,647,068€ Prej kësaj vlere ne kemi testuar gjithsej 12 mostra në vlerë prej 1,149,938€pa TVSh.

Borxhi total i pjesës jugore të NSh Trepçës ndaj KEK-ut ishte 4,032,549€ Për këtë NSh Trepça ka nënshkruar marrëveshjen e ujdisë për pagesë të borxheve dhe është rregulluar çështja e pagesës dhe ri programimi i borxhit të mbetur.

NSh Trepça ka filluar me pagesën e obligimeve sipas kushteve të caktuara në marrëveshje në mes të dy palëve.

Testimet tona nuk kanë shpalosur ndonjë të gjetur lidhur me këtë shpenzim.

Kompensimet - pagat dhe mëditjet

Shpenzimet totale për paga dhe mëditje për vitin 2010 janë 6,971,136€ Prej tyre 4,680,490€ janë paguar nga të hyrat vetanake, ndërsa pjesa tjetër prej 2,290,639€nga BK.

Në këtë kategori të shpenzimeve ne kemi kryer procedura analitike dhe kemi ekzaminuar disa dosje të personelit. Testimet tona kanë shpalosur të gjeturat në vijim:

- Menaxhimi i personelit në NSh Trepça nuk është i rregulluar me politika ose rregullore të brendshme. Në mungesë të statusit të ndërmarrjes nuk është plotësisht e qartë përgjegjësia për nxjerrjen e politikave (AKP-së apo NSh Trepça). Si pasojë e kësaj ka paqartësi në menaxhimin e personelit;
- Në disa raste punësimi i stafit të ri në ndërmarrje është bërë pa konkurs publik. Kjo tregon se ka munguar transparenca e plotë, që mund të ketë ndikim në cilësinë e menaxhimit të NSh Trepça;
- Në kontratat e të punësuarve në ndërmarrje, nuk ka një përshkrim të qartë të pozitës së punës. Si pasojë e kësaj të punësuarit nuk i kanë shumë të qarta detyrat dhe përgjegjësitë. Kjo situatë mund të ketë ndikim edhe në performancën e ndërmarrjes në tërësi; dhe
- Për të punësuarit në ndërmarrje nuk bëhen vlerësime periodike të performancës. Sipas zyrtarëve për personel vlerësimi periodik i të punësuarve nuk është bërë për shkak se nuk ka një rregullore e cila e obligon ta bëjë këtë.

Megjithatë në fazën e dytë të auditimit ne kemi vërejtur se Ndërmarrja është në hartim e sipër të “Rregullores për marrëdhënien e punës të NSh Trepça në administrim të AKP-së”, në përputhje me Ligjin e Punës. Përveç kësaj është aprovuar “Rregullorja për organizim të brendshëm” në të cilën ka një përshkrim më të detajuar të pozitave të punës.

Konkluzioni

Mungesa e politikave dhe rregullave të brendshme për menaxhimin e procedurave të personelit na shpjen në mendimin se pjesa jugore e NSh Trepça nuk kishte arritur të siguroj kontrollë funksionale. Parregullsitë ishin prezentë nga faza e rekrutimit të të punësuarve e deri të mos arritja e vlerësimit vjetor të përfomancës.

Rekomandimi 7

Rekomandojmë Menaxhmentin e NSh Trepça të siguroj:

- Miratimin e “Rregullores për marrëdhënien e punës të NSH Trepça në administrim të AKP-së”, në përputhje me Ligjin e Punës; dhe
- Transparencë gjatë pranimit të stafit të ri në punë në mënyrë që të pranohet staf profesional në pajtim me kërkesat e parapara.

Pensionet e parakohshme për vitin 2010

Me qëllim të sigurimit të një mirëqenie sociale më të favorshme për punëtorët e NSh Trepça dhe minierat tjera me mihje nëntokësore, Ministria e punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) kishte nxjerrë UA Nr. 10/2007 për përcaktimin e kushteve për realizimin e pensioneve të parakohshme. Shuma mujore e pensionit të parakohshëm sipas këtij udhëzimi është 50€ dhe financohet nga BK. Ndërsa me vendim të NSh Trepça, me rekomandim të MPMS-së dhe AKM-së, kjo shumë ishte ngritur për disa departamente të ndërmarrjes nga 50€ në 80€, ku këtë diferencë prej 30€ do ta paguante NSh Trepça nga të hyrat vetanake.

Pjesa jugore e NSh Trepça në fund të vitit 2010 kishte 3,353 pensionistë të parakohshëm, ndërsa 1,197 nga ata përfitojnë edhe shtesën prej 30€ nga të hyrat vetanake. Shpenzimet totale për pensione të parakohshme për vitin 2010 janë 2,376,670€ Nga kjo shumë 447,960€ janë paguar nga të hyrat vetanake, ndërsa pjesa tjetër prej 1,928,710€ nga BK.

Në këtë kategori të shpenzimeve ne kemi kryer procedura analitike dhe kemi ekzaminuar disa dosje të punëtorëve përftues të pensioneve të parakohshme.

Në mostrat e ekzaminuara ne nuk kemi hasur ndonjë parregullsi.

Stipendionet

Stipendionistët janë ish punëtorë të NSh Trepça, në pritje për t’u punësuar në momentin kur ndërmarrja është e gatshme të pranojë punëtorë të ri. Stipendionistët përfitojnë një shumë prej 30€ në muaj. Nuk ka një rregull të qartë e cila e rregullon dhënien e këtyre stipendioneve.

Në fund të vitit 2010 pjesa jugore e NSh Trepça kishte 320 stipendionistë. Shpenzimet totale për stipendione për vitin 2010 janë 126,323€ Nga kjo shumë 82,013€ janë paguar nga të hyrat vetanake, ndërsa pjesa tjetër prej 44,310€ nga BK.

3.3 Pasuritë dhe borxhet

Pasuritë kapitale dhe jo kapitale

Ne kemi ekzaminuar menaxhimin e pasurisë në përgjithësi në NSh Trepça. Testimi jonë ka shpalosur të gjeturat në vijim:

Pasuritë e Trepçës nuk menaxhohen nga zyrtarët e saj

Sipas UA 21/2009 Menaxhimin e Pasurisë Qeveritare kërkohen që çdo Ndërmarrje të ketë Zyrtarin e Pasurisë dhe Zyrtarin e Logjistikes.

Pjesa jugore e NSh Trepça nuk ka Zyrtar të Pasurive dhe Zyrtar të Logjistikës për pranimin e mallit. Si pasojë vërehet se nuk kishte menaxhim të mirë të pasurisë. Nuk kishte regjistër të pasurive dhe nuk ishte formuar Komision për vlerësimin dhe inventarizimin e pasurisë.

Sipas zyrtarëve përgjegjës, arsye për mos përmbushjen e këtyre obligimeve është se pronar i Trepçës është AKP dhe zyrtarët e tyre duhet të merren me menaxhimin e pasurisë së kësaj Ndërmarrje.

Konkluzioni

Konkludojmë se pjesa jugore e NSh Trepça nuk ka instaluar fare sistem të kontrollit mbi menaxhimin e pasurisë të cilën e posedon, duke krijuar hapësirë të mjaftueshme që kjo pasuri të humbet ose keqpërdoret.

Rekomandimi 8

Rekomandojmë Menaxhmentin e NSh Trepça të siguroj që:

- Pasuritë e ndërmarrjes menaxhohen nga vetë Zyrtarët e saj. Në kuadër të saj të caktohet Zyrtari për Menaxhimin e pasurisë si dhe Zyrtarin për Logjistikë; dhe
- Formimin e komisionit për vlerësimin e pasurisë dhe regjistrimin e plotë të tyre në regjistrin e pasurisë.

Detyrimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve ndaj furnitorëve në fund të vitit 2009 ishte në vlerë prej 4,679,000€ Në fund të vitit 2010 obligimet ishin 4,668,201€ me një zvogëlim prej 10,799€

V. Kontrolli Menaxherial

V.1 Sistemet e Kontrollit të Brendshëm

Sistemi i mirë i kontrollit të brendshëm e ndihmon çdo Ndërmarrje në arritjen e objektivave të përcaktuara në shfrytëzimin sa më të mirë të parave publike, duke siguruar raportim të besueshëm financiar.

Ne testuam në përgjithësi sistemin e kontrollit të brendshëm dhe identifikuam dobësitë në fushat në vijim:

- NSh Trepça nuk funksionon si një tërësi. Ajo është e ndarë në dy pjesë. Të dy pjesët menaxhojnë me buxhetin e tyre dhe nuk kanë ndonjë raportim të përbashkët përpos rrjedhjes së parasë;
- NSh Trepça ende nuk ka nxjerrë statutin e ndërmarrjes. Përpos kësaj ende nuk ka nxjerrë të gjitha politikat ose rregulloret e brendshme të cilat do të rregullonin menaxhimin dhe administrimin e ndërmarrjes; dhe
- Nuk bëhen vlerësime vjetore për performancën e stafit në ndërmarrje. Kjo mund të këtë ndikim në mos identifikimin e dobësive në performancën e stafit.

Konkluzioni

NSh Trepça nuk ka arritur të vendos një sistem funksional të kontrollit. Fakti që ajo funksionon e ndarë në dy pjesë na bënë të kuptojmë se mungon përgjegjësia dhe llogaridhënia. Po ashtu mungon një kornizë e aplikueshme ligjore për menaxhimin e të hyrave dhe menaxhimin e personelit.

Rekomandimi 9

Rekomandojmë Menaxhmentin e NSh Trepça të siguroj:

- Të gjitha politikat dhe rregulloret e brendshme të cilat rregullojnë menaxhimin e ndërmarrjes;
- Vlerësimin vjetor të stafit në mënyrë që të ketë një pasqyrë të performancës së tyre; dhe
- Forcimin e aktiviteteve të kontrollit të brendshëm në mënyrë që të bëjë parandalimin e gabimeve dhe parregullsive të mundshme.

V.2 Auditimi i Brendshëm

Auditimi i brendshëm është segment i rëndësishëm për të siguruar menaxhmentin e lartë se mekanizmat e kontrollit të brendshëm janë dizajnuar dhe zbatohen në mënyrën e duhur. Aty ku vërehet se kontrollet e brendshme nuk funksionojnë si duhet, auditimi i brendshëm ofron këshilla dhe rekomandime se si ato të përmirësohen.

Njësia e auditimit të brendshëm në pjesën jugore të NSh Trepça është themeluar në Mars të vitit 2009. Kjo njësi kishte një auditor.

Në fushën e auditimit të brendshëm ne testuam procesin prej fazës së planifikimit e deri të faza e adresimit të rekomandimeve. Kjo njësi kishte përgatitur një plan të auditimit në të cilin përfshihen fushat më të rëndësishme.

Gjatë vitit 2010 kjo njësi ka përfunduar gjithsej nëntë auditime. Në përgjithësi auditimet kanë mbuluar vitin 2010 siç janë: dy auditime në Departamentin e Prokurimit dhe Financave, një auditim për Kontrata të Qirasë, një auditim me kërkesë të menaxhmentit për një lëndë të prokurimit, katër Auditime për Depot dhe një Auditim për Paranë e Imët.

Ne kemi analizuar këto raporte dhe kemi vërejtur se auditimi i brendshëm kishte nxjerre konkluzione dhe rekomandime të qarta.

Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk kishte përfshirë në planin e saj të gjitha fushat të cilat kanë rrezik me të lartë siç është pasuria.

Konkluzioni

Njësia e auditimit të brendshëm ka arritur të nxjerr konkluzione dhe rekomandime në këto fusha të auditimit, mirëpo në të ardhmen duhet të zgjeroj fushëveprimin dhe objektivin e auditimit në mënyrë që t'i shtoj vlerë menaxhimit dhe funksionimit të kontrolleve të brendshme.

Rekomandimi 10

Rekomandojmë Menaxhmentin e NSh Trepça të siguroj që:

- Gjatë përgatitjes së planit vjetor të auditimit të përfshihet një fushëveprim më i gjerë (pasuritë) në mënyrë që ti ndihmojnë dhe ti shtojnë vlerë menaxhimit të organizatës.

VI. Konkluzion i Përgjithshëm

Duke u referuar në të gjeturat dhe konkluzionet e këtij raporti vijmë në konkluzionin e përgjithshëm se Bordi i AKP-së dhe Menaxhmenti i NSh Trepça ende nuk ka arritur të forcojnë sistemin e kontrollit të brendshëm.

Procesi i raportimit të NSh Trepça nuk funksionon si një tërësi. Ajo është e ndarë në dy pjesë. Të dy pjesët menaxhojnë me buxhetin e tyre dhe nuk kanë ndonjë raportim të përbashkët, përpos rrjedhjes së parasë.

NSh Trepça ende nuk e ka përcaktuar përfundimisht statusin e saj, andaj i mungonte korniza ligjore për disa fusha. Kjo është vërejtur sidomos të menaxhimi i të hyrave dhe të menaxhimi i burimeve njerëzore.

Nga pasqyrat financiare vërehet se të dy pjesët kanë rezultat financiar pozitiv dhe ka përmirësim të gjendjes në raport me të kaluarën. Mirëpo ende pjesa më e madhe e të hyrave realizohen nga shitja e koncentreve të plumbit dhe zinkut. Të menaxhimi i blerjeve përmes prokurimit nuk kishte kontroll të duhur. Parregullsitë ishin vërejtur nga planifikimi e deri të realizimi i prokurimeve.

Problem serioz është menaxhimi i pasurive. Nuk ka Zyrtar të pasurive dhe nuk janë vlerësuar dhe regjistruar pasuritë.

Rekomandimi i përgjithshëm

Rekomandojmë Bordin e AKP-së dhe Menaxhmentin e NSh Trepça që të rishikojnë mundësinë për të forcuar bashkëpunimin në mes të dy pjesëve. Të përcaktoj statusin e saj dhe të plotësoj kornizën e brendshme ligjore. Po ashtu të analizoj fushat me mangësi të theksuara, si dhe të ndërmerr veprime të mëtutjeshme në përmirësimin e kontrollit të brendshëm.

Shtojca I. Komentet e NSH Trepça -së dhe përgjigjet e ZAP-së

Menaxhmentit të NSH Trepçës i është dhënë mundësia për të dhënë komente mbi draftin e këtij Raporti. Menaxhmenti i pjesës jugore të NSH Trepçës ka pranuar të gjeturat dhe konkluzionet tona të paraqitura në Raportin e Auditimit mbi Sistemin e Kontrollës, Linjat e Raportimit si dhe Menaxhimin Financiar dhe nuk ka dhënë ndonjë koment.

Më tutje, ata janë zotuar se do ti bëjnë të gjitha përpjekjet për ti adresuar të gjitha rekomandimet e dhëna.

Menaxhmenti i pjesës veriore të NSH Trepça ka bërë komente në Raportin e Auditimit mbi Sistemin e Kontrollës, Linjat e Raportimit si dhe Menaxhimin Financiar, të cilat i kemi paraqitur në vijim.

Kapitulli në Raport	Pajtohem	Pajtohem pjesërisht	Nuk pajtohem	Komentet nga NSH Trepça (Pjesa Veriore)	Përgjigja e ZAP-it
V.2 Shpenzimet					
2.1 Blerjet përmes prokurimit					
Të gjeturat:			X	Me rastin e raportit të auditimit të cilin na keni dorëzuar, mendimi ynë është se ai është bërë në mënyrë tejet tendencioze dhe të pavërtetë. Departamentet e Trepçës Veri i përmbahen në mënyrë të përpiktë të gjitha rregullave ligjore pozitive që i përkasin veprimtarisë sonë.	Ne kemi kontaktuar Zyrtarët e pjesës veriore të NSH Trepça dhe kemi kërkuar të kryejmë auditimin edhe në atë pjesë. Ata nuk kanë pranuar të kryhet auditimi në atë pjesë. Arsye sipas tyre ishin problemet politike. Ne kemi pranuar nga kjo pjesë vetëm pasqyrat financiare në forme elektronike dhe dy lëndë të prokurimit në kopje fizike. Nga auditimi i këtyre lëndëve kemi vërejtur se kishte parregullsi gjatë menaxhimit të tyre. Për pjesën tjetër të dokumenteve ne kishim kufizim të fushëveprimit.